

Këtu mund të gjendet një përshkrim i detajuar i jetës së Hahnit, i cili është i vlershëm për shkak të saktësisë së faktit dhe të theksit të autorit në lidhje me kontributin e Hahnit në historinë e Shqipërisë dhe të Ballkanit. Por, pa dashur të cenohet autoritetin shkencor të profesorit të nderuar, kujtoi se ai është duke i bërë një shërbim edhe më të madh albanologjisë me themelimin e edicionit *Albanische Forschungen* (Gjurmime shqiptare), në të cilin edicion kanë dalë gjer më sot shtatë vepra të vyera. Në anën tjetër, prof. Shtatmyler, duke i drejtuar studentët dhe asistentët e vet drejt studimeve shqiptare dhe balkanologjike është duke krijuar një kuadër specialistësh të rinj e ambiciozë.<sup>2</sup> Si libër i parë i këtij edicioni është vepra voluminoze e lartpërmendur, kushtuar albanologut të njohtur J. G. Hanit, Qysh në fillim duhet theksuar se kjo është një monografi e zakonshme mbi jetën e veprën e Hanit, por është diçka edhe më tepër, është një kontribut për historinë e albanologjisë, e cila në kohën e Hanit, e ndoshta me të, merr suazat ma të vërtetë shkencore dhe shpie drejt rezultateve që janë arritur gjer më sot.

GERHARD GRIMM, *Johann Georg von Hahn (1811—1869)*, Wiesbaden, Otto Harrassowitz 1966, 385 f. in 8° (Albanische Forschungen 1)

Prof. Dr. Georg Stadtmüller drejtor i Institutit të historisë së popujve të Evropës juglindore të Mynhenit u është tepër mirë i njohur ndër historianët e Shqipërisë dhe të Ballkanit. Por, pa dashur të cenohet autoritetin shkencor të profesorit të nderuar, kujtoi se ai është duke i bërë një shërbim edhe më të madh albanologjisë me themelimin e edicionit *Albanische Forschungen* (Gjurmime shqiptare), në të cilin edicion kanë dalë gjer më sot shtatë vepra të vyera. Në anën tjetër, prof. Shtatmyler, duke i drejtuar studentët dhe asistentët e vet drejt studimeve shqiptare dhe balkanologjike është duke krijuar një kuadër specialistësh të rinj e ambiciozë.<sup>2</sup> Si libër i parë i këtij edicioni është vepra voluminoze e lartpërmendur, kushtuar albanologut të njohtur J. G. Hanit, Qysh në fillim duhet theksuar se kjo është një monografi e zakonshme mbi jetën e veprën e Hanit, por është diçka edhe më tepër, është një kontribut për historinë e albanologjisë, e cila në kohën e Hanit, e ndoshta me të, merr suazat ma të vërtetë shkencore dhe shpie drejt rezultateve që janë arritur gjer më sot.

Pas një hyrjeje të shkurtë, autori jep pasqyrën e gjurmimeve të deritanishme mbi jetën dhe veprën e Hanit. Sado që në një numër të madh të enciklopedive botërore Hani nuk ka mbetë pa u përmendë, prapseprap thuhet asnjë studim më serioz nuk i është kushtuar këtij albanologu dhe

helenisti të madh. Madje, edhe ndër shqiptarët thuejse nuk është shkruar diçka serioze për të.

Kapitulli i dytë (14—113) i është kushtuar jetës së Hanit. Hani ka lindur më 11 qershor 1913 në Frankfurt, si fëmijë i një mjeku ushtarak. Pas një kohe prindët e tij kaluan në Hamburg, ku Hani filloi shkollimin e parë. Në këtë kohë, shpërtheu kryengritja greke, e cila e tundi opinionin publik evropian. Nga shumë vende evropiane arritën vullnetarë në Greqi për të luftuar për lirinë e popullit grek. Këto ngjarje qenë vendimtare për karrierën e mëvonëshme diplomatike të Hanit. Më 1823 Hani kaloi në Majnc, ku studjoi latinisht, greqisht, frengjisht, matematikë, histori dhe disiplina të tjera humaniste. Prej vitit 1828 deri 1829 Hanin e gjemë në qytetin e vogël Gizen, kurse në vjeshtë të vitit 1829 kaloi në Universitetin e Hajdenbergut, ku studjoi drejtësinë. Njëkohësisht në fakultetin e filozofisë ndëgjoi mësimet e arkeologjisë, teologjisë komparative dhe të letërsisë greke-romake. Më 1832 mbaroi studimet, duke mbrojtur një disertacion nga e drejta krahasore romake e gjermane në gjuhën latine. Në vitin 1834, me qenë se fuqitë e mëdha patën dhënë aprovimin që në frontin e Greqisë të vijë princi i Bajerisë Oto, një pjesë e madhe nëpunësish, oficerësh dhe ekspertësh të ndryshëm arritën në Greqi e bashkë me ta edhe Hani, i cili hyri në punë në Ministrinë e drejtësisë. Më 1835 Hani kaloi në qytetin grek Tripolisa, ku ishte i shtrënguar të flasë vetëm greqisht. Këtu lindi edhe interesi i tij i parë për gjurmimet shkencore. Më 1836 kaloi në Nauplia, e më vonë në Eubea (Kaliks). Prej vitit 1843—1847 Hanin e gjejmë si konsull previzor të Prusisë në Athinë, kurse më 1847 Hani emërohet si vicekonsull i Austrisë në Janinë. Në këtë kohë sipas Hanit, Janina kishte 26 mijë banorë prej të cilëve 15 mijë grekë, 2500 ebrej dhe të tjerët muslimanë shqiptarë. Këtu filloi të mësojë shqip. Përveç gramatikës së Xylanderit ai angazhoi edhe dy shqiptarë, të cilët në atë kohë studjonin në Gjimnazin Zosimea të Janinës. Njëri nga këta ishte gjuhëtari i mëvonshëm shqiptar, Konstantin Kristoforidhi, të cilin Hani e nxiti që më vonë t'u kushtohet studimeve të shqipes. Është interesante që raportet e Hanit nga kjo kohë janë ruajtur në Arkivin e Vienës dhe kanë një rëndësi të madhe për studimin e Shqipërisë së Jugut. Më 1850 Hani ngarkohet ta studjojë situatën në Shqipëri, me qenë se Austria kishte ndërmend të hapte edhe konsullata të tjera, në Durrës dhe Shkodër. Ai mori instrukcione nga Ministria e jashtme që të studjojë situatën politike të Shqipërisë, influencën e Anglisë dhe të shteteve të tjera, gjendjen e kishës katolike, ipeshkëvet e së cilës merrnin ndihmë materiale nga Austro-Hungaria. Kështu, në korrik të 1850 ai nisët dhe arrin në Vlorë, vazhdon për Durrës e arrin në Shkodër. Në nëndor të po atij viti arrin në Vienë për t'i kaluar pushimet. Gjatë kësaj rruge ka mbajtur ditarin e vet me shënime tepër interesante. Në vjeshtë të vitit 1851 Hani arrin në Syroz, si konsull i Austrisë për Greqinë Lindore, ku mbeti gjer më 1855. Në ndërkohë, në Jena u botuan „Albanische Studien“ (1854), të cilët e bënë të njohur ndër qarqet shkencore. Në këtë kohë ai iu kushtua studimit të veprave të Homerit. Në shtator të vitit 1858 pasi kaloi pushimet në Vienë, Hani vendosi të ndërmarrë një udhëtim nëpër Maqedoni, prej Veriut në Jug. Natyrisht, ky udhëtim, përveç pasionit shkencor të Hanit, kishte edhe qëllime politike, sepse Austro-Hungaria që në atë kohë mendohte për ndërtimin e hekurudhës në trevën e Moravës e të Vardarit. Prej Beogradit rrugës së Moravës Hani arriti në Nish, e prej këtu në Vranjë. Rrugës mori shënime të ndryshme që e interesuan, sidomos mbi vendet, numrin e shtëpive, të banorëve, emrat e maleve. Ai interesohet për fiset shqiptare në Krahinën e Nishit. Shpesh kemi observacione tepër interesante mbi popujt e ndryshëm. Kështu, ai shkruan se shqiptarët interesoheshin për revolen e tij me gjashtë fishekë, kurse bullgarët për një dyshek që mbushej me ajr. Për të vu në pah karakterin më aristokratik të shqipëtarëve në krahasim me bullgarët, Hani thotë: „Kur pyet diçka një grup shqiptarësh, përgjigjet vetëm më i vjetri midis tyre, kurse kur i pyet bullgarët që të gjithë përgjigjen njëzëri“. Prej Vranje Hani arrin në Shkup, pastaj në Fushë Kosovë, Prishtinë, nëpër luginën e Lepencit del prap në

Shkup, Veles e Selanik. Kështu lindi libri i tij „Udhëtimi prej Beogradi në Selanik”. Prej vitit 1859—1863 Hani është përsëri në Syra. Në këtë kohë ai angazhohet për ndërtimin e hekurudhës Beograd—Selanik. Në të vërtetë, qysh më 1836 Ami Boue kishte bërë një plan për rrjetën hekurudhore në Ballkan, sipas të cilit vija kryesore do të shkonte në drejtim Beograd—Nish—Sofje—Stamboll, e degët e saj Nish—Selanik—Durrës. E pas luftës së Krimesë edhe Turqia filloi të interesohet drejtpërdrejt për planet e tilla. Në dimrin e vitit 1862—63 Hani vendosi t'i përkthejë dhe t'i botojë „Tregimet greke dhe shqiptare”, të mbledhura qysh më parë në Janinë e rrethinat e saj. Hani është mbledhësi i parë i tregimeve popullore shqiptare. Pas kësaj, ai kërkoi ndihmë materiale prej Akademisë së shkencave të Vienës për të realizuar planin e vjetër, studimin e rajonit të Drinit e të Vardarit. Për Drinin ai thotë se „Nga të gjithë lumenjt e Evropës është më i panjohuri”. Më 12 gusht Hani arrin me vapor në Durrës, e prej këtu, bashkë me një ekip, fillon udhëtimin e vet duke mbledhur kudo materiale historike, etnografike, toponomastike e folkloristike etj. Prej Durrësi arrin në Tiranë, e pastaj në Mat. Ditë me radhë këtu u mundua të gjejë këngë popullore kushtuar Skënderbeut, por të gjitha përpjekjet e tij dështuan. Ai mundi të mbledhë vetëm disa legjenda mbi Skënderbeun. Këtu konstatoi se popullësia e Matit i përmbahet „Kanunit të Skënderbeut”, e jo atij të Lekë Dukagjinit. Pas 18 ditësh udhëtimi, ai arriti në Shkodër, ku iu bashkue pjesa tjetër e ekipit, midis tjerësh edhe një nga fotografët më të mirë të Austrisë, Szekley. Duke lundruar me dy lundra të vogla, ekipi arriti në Dukagjin, në një vend afër Topojanit, prej ku rrugën e vazhduan këmbë. Nëpër Krasnëq grupi arriti në Prizren. Përveç të dhënave statistikore mbi shtëpitë, popullësinë, përkatësinë fetare, Hani shënon se „popullësi të ndryshme këtu jetojnë njëri pranë tjetrit, pa kurrfarë kufini”. Tërë tregëtia është në duart e të krishterëve, të cilët, për shkak të rrugëve të këqia kah Shkodra, importojnë prodhimet e manifakturës angleze nëpër Selanik, kurse lëkurën e Sahtianit dhe prodhimet e tjera i liferojnë kah Serbia në Hungari”. Prej këtu ekspedita kthehet prap, Drinit të Zi. Janë interesante shënimet mbi gegërishten. Hani, që mësoi dialektin toskë dhe jetoj në Janinë, thotë se gati nuk i merr vesh Matjanët kur flasin midis tyre. Më 21 shtator 1873 ai arrin në Dibër, e prej këtu nëpër trevën e Strugës në Ohër, pastaj, në Prespë, Prilep, Veles e Selanik. Si rezultat i këtyre udhëtimeve është libri i tij i mirënjohur „Udhëtimi nëpër viset e Drinit dhe të Vardarit”.

Prej vitit 1864 deri 1869 Hani kalon në Syra. Mirëpo, në kallnor të 1869 sëmuhet nga astma. Në prill arrin në Vienë dhe përpiqet të shërohet, por më 25 shtator 1869 vdes.

Në pjesën e tretë të kësaj vepre të çmuar është përpunuar hollësisht „Aktiviteti dhe veprimtaria e Hanit si gjykatës dhe konsull”. As kjo pjesë nuk është më pak interesante për ne. Këtu është përpunuar së pari problemi i „Ndërtimit të jurisprudencës greke, pastaj kapitulli në të cilin përpunohen raportet e Hanit dërguar në Vienë në lidhje me tregëtinë, të cilat raporte nxjerrin në dritë interesin e Austrisë për tregëtinë e Ballkanit, pastaj puna e Hanit në përmirësimin e rrjetës së konsullatave. Veçanërisht bie në sy rëndësia e raporteve politike të Hanit në lidhje me kufinin greko-turk, ose më mirë greko-shqiptar, ku kemi materiale të dorës së parë të përpunuara sistematikisht dhe të parashtruara si duket. Nuk mungojnë as të dhënat mbi kryengritjet e ndryshme shqiptare të Toskërisë. Hani, me një sy të mprehtë prej vëzhguesi ka ndjekur edhe zhvillimin e marrëdhënjëve të brendëshme me Greqinë, luftën e Kretës e të tjera. Një kapitull i kushtohet „Austrisë dhe Evropës juglindore”. Me një fjalë, edhe në këtë pjesë kemi një varg të dhënash të reja, nxjerrë nga materialet e pabotuara ose më mirë nga raportet e pabotuara të Hanit. Pjesa e katërt e librit, që është edhe më e shkurtëra, (179—192) i kushtohet veprimtarisë së Hanit në interesin publik”, ku bëhet fjalë mbi projektet hekurudhore të Ballkanit dhe kërkesat e tij për zhvillimin e lundrimit.

Kapitulli i katërt (192—285) është ndoshta më interesante në këtë libër. Ai u kushtohet përpjekjeve shkencore të Hanit. Këtu janë përpunuar dhe analizuar shkrimet e Hanit në gjuhën shqipe, lidhur me alfabetin, historinë, etnografinë dhe folklorin. Autori i librit nuk i parashtron vetëm mendimet e Hanit, por e vendos Hanin në kuadrin e epokës së vet, jep gjendjen e synimeve albanologjike në atë kohë, kontributin e Hanit, gabimet e iluzionet që i ka rektifikuar shkenca e mëvonshme.

Përveç veprave të botuara të Hanit, autori ka përdorë edhe raportet e e tij të pabotuara, shumë letra private dhe korespondencën e tij me shumë dijetarë të asaj kohe, e mu nga këto letra shihen më së miri mendimet e problemet. Në vazhdim bëhet fjalë për studimet e Hanit mbi Greqinë dhe Maqedoninë, e pastaj mbi „Tregimet” që është padyshim tepër interesant për çdo folklorist tonin.

Në pjesën e gjashtë të veprës (286—329) autori bën përpjekje të suksesshme për të dhënë pasqyrën e përgjithshme të personalitetit dhe të veprimit të Hanit, kurse në pjesën e shtatë e të fundit, (330—364) flet mbi „Burimet e pabotuara dhe vendet ku gjinden ato”, mbishkrimet e pabotuara të Hanit dhe mbi bashkëpunëtorët e tij. Në fund është dhënë pasqyra e shkurtesave, bibliografia e pasur, që e ka përdorë autori, por nuk dimë për ç’arësye nuk është rrjeshtuar sipas rendit alfabetik.

Duke përfunduar këtë paraqitje të veprës së Gerhard Gemit e ndjej për detyrë që edhe njëherë të vej në pah se kjo vepër na jep shumë më tepër se sa thotë vetë titulli i saj. Prandaj, ishte një punë tepër e vështirë ta përmbledhish gjithë këtë material, dhe të japish ndonjë mendim për të, por, qëllimi ynë ishte vetëm t’u japim lexuesve tanë një ide të përgjithshme mbi përmbajtjen e kësaj vepre, sepse përpjekja për të folur më hollë për të, do të na çonte shumë larg. Madje mendoj se disa kapituj do të duhej t’i përkthejmë.

HASAN KALESHI